Гайдарче, Гайда, Гайде, ако не  
свирам нема фајде.*

T. Nankova



*interpretues  
në festival në f.  
Dollneni*



### Rekomandimi për dëgjim:

Vallja e Pajdushkës në interpretim të Pece Atanasovski.







*fyelli*

## Fyelli

*На сред село чеима шарена,  
на сред село вода студена,  
по поле зелен клас  
од шупелка надалеку се слуша Глас.*

T. Nankova

Fyelli është instrument me frymë, popullore, tradicionale maqedonase, i cili është i ngjashëm me kavallin, mirëpo me gjatësi më të shkurtër. Përpunohet prej drurit të arrës, të thanës, të frashrit apo drurit të panjës.

Ka gjashtë vrima dhe ngushtim në shtyllën e ajrit përgjatë pjesës së sipërme. Toni prodhohet me fryrjen në hapjen e sipërme të instrumentit. Me hapjen dhe mbylljen e hapjeve me të dyja duart, fitohen tone të ndryshme sipas lartësisë. Derisa i bie, fyelli mbahet në kënd prej 45°. Më shpesh shfrytëzohet si instrument solisti në shoqërim me instrumente tjera. Në traditë njihet si instrument solisti dhe instrument bariu.



*interpretues i fyellit*



*pjesë të vrimave të fyellit*



### Vallë, e keni ditur?

Arabët përdorin instrument me formë të njëjtë sikurse fyelli ynë, i quajtur “gasba”, që donë të thotë „kallam”. Këto dy instrumente sipas formës dhe mënyrës së prodhimit të tonit janë thuajse të njëjta.



### Rekomandimi për dëgjim:

Melodia për solo - ekzekutim të fyellit.



## Zamarja

*На мене се свири лесно  
зашто имам Грло тесно.  
Свирам на две октави,  
тоа се дудучиња прави.*  
T. Nankova



Zamarja është instrument me frymë, popullore, tradicionale maqedonase me fund paralel. Përpunohet prej drurit të frashrit, të panjës apo ndonjë druri tjetër. Ka formë cilindri me mesatare prej 25 deri në 30mm. Ndërtohet në dy madhësi: **zamarja e vogël** me madhësi prej 240 - 400mm dhe **zamarja e madhe** me madhësi prej 700 - 780mm. Zamarja është shpesh i përfaqësuar në muzikën instrumentale popullore në Maqedoni. Tingullin e ka të pastër dhe të mirë. Kur i bie zamares, ajo mbahet me të dyja duart, në mënyrë vertikale dhe para vetes. Numërohet në instrumentet soliste të barinjve. Në Maqedoni masovikisht është e përhapur në të gjitha sferat.



*Stefçe Stojkovski*



### **Rekomandimi për dëgjim:**

Melodi nën interpretim të zamares.



### **Detyrë:**

1. Me përdorimin e IKT-së bëj një album me instrumentet popullore me frymë.





## Nga krijimtaria e Zhivoin Glishiq



*Zhivoin Glishiq*

Njëri ndër kompozitorët më të njohur bashkëkohor maqedonas është Zhivoin Glishiq. Lindi më 1954 në Shkup. Ende në vitet e hershme filloi me edukimin muzikor. Në fillim i binte kitarës, pianos dhe borisë.

Diplomoi dhe punoi në Fakultetin e Artit Muzikor në Shkup, si profesor në drejtimin e teorisë së muzikës, pedagogjisë dhe kompozimit.

Në fillim, orientimi i tij muzikor ishte në njohjen dhe përsosjen e xhez - teknikave, ku krahas teorisë klasike, vëmendje të madhe përkushtoi edhe në studimin e xhezit dhe muzikës jugoamerikane.

Krijimtaria e tij begatohet me vepra vokale, vepra instrumentale dhe vepra vokale - instrumentale. Frymëzimi më i shpeshtë është folklori i pasur muzikor maqedonas i cili përmes gjuhës kompozitore bashkëkohore dhe me njohjen e xhez - teknikave kumbon mirë në harmonitë e pasura.

### *„Денот на Јана, танцот на Јана”*

Frymëzimi për krijimin e kompozimit „Денот на Јана, танцот на Јана” (Jana’s day Jana’s dance) është traditë valltare maqedonase. Motivi kryesor është Vallja e Janinos. Në fillimin burimor dhe fillimin e ngadalshëm të valles popullore paraqitet tingulli luksoz i gajdes, i shoqëruar me zërin e kavallit dhe instrumenteve me tel. Kreshendoja e mirë në tingullin e gajdes e lajmëron lëvizjen ritmike e cila jep freski të re të interpretimit.

Në kompozimin „Денот на Јана, танцот на Јана” sfidë për dëgjuesin është lidhja e jopërditshme instrumentale dhe tingulli i kavallit, gajdes, tamburit, tastierave, bas kitarës dhe instrumenteve me goditje.

Ky kompozim është ekzekutuar në festivalin Vera e Ohrit - 2008.



### **Detyrë:**


1. Hetoji dhe emëroji instrumentet popullore në kompozimin „Денот на Јана, танцот на Јана”.



# Виножито

(dëgjojmë dhe këndojmë një këndë për natyrën)

Музикën dhe тексти: Risto Samarxhiev




Со каква четка  
синилото се бои?  
Баш таква слика  
таму да стои.

Прекрасни бои  
небото крои,  
сонце што грее,  
птица што пее.

*рефрен:*  
Виножито, виножито,  
баба вели суница.  
Виножито,  
на небо и всапуница







## Shprehja artistike dhe letrare (ylberi me ngjyra në gjininë e tonit)

Përjetimi i gjinisë së tonit të veprës së dëgjuar përmes shprehjes dhe krijimtarisë letrare „Виножито”.

### Aktiviteti:



Arsimtari demonstroi fotografi të ylberit – simboli i gjinisë së tonit - dur, me ngjyra më të errëta dhe fotografi të ylberit – simboli i gjinisë së tonit - mol, me ngjyra më të ndritshme.

### Aktiviteti i arsimtarit:

Demonstrimi i shembujve muzikorë në tonalitet të mol-it dhe dur-it;

### Aktiviteti i nxënësit:



Bërja e vizatimit – ylberi në ngjyra më të errëta, simboli për përjetimin e gjinisë së dur-it;



Bërja e vizatimit – ylberi në ngjyra më të ndritshme, simboli për përjetimin e gjinisë së mol-it.

### Në vazhdimësi të aktivitetit vijon:



Prezantimi individual i punimeve të nxënësit.



Diskutimi dhe vlerësimi i prezantimit.



### Rekomandimi:

Ky aktivitet mund të realizohet edhe në përmbajtje të temës mësimore të këndimit të këngëve.



# Tambura

*Тажни звуци леам  
за анамата песна пеам.  
За љубовта толку чиста  
за нашаша љубов иста.*

T. Nankova



tambura

Tambura është instrument me tel, popullor, tradicional maqedonas. Këtë instrument e sollën turqit në Maqedoni rreth shekullit të 14-të dhe 15-të. Përpunohet prej drurit të blirit, të panjës, të dardhës apo ndonjë lloji tjetër të drurit.

Tambura përbëhet prej tre pjesësh: **korpusi (trupi), qafa dhe koka.**

**Korpusi** përpunohet në formë të konusit me maje të rrumbullakët dhe në formë të dardhës së prerë. **Qafa** është e gjatë dhe e hollë me gjatësi prej 360 – 500mm. Në **kokë** gjenden pykat ku janë të përforcuara telat.

Kur i bie tamburit, ajo mbahet në pozitë horizontale dhe e kthyer në anën e majtë. Tingulli fitohet kur me dorën e djathtë dhe me ndihmën e dridhëses i bie telave. Me shtypjen e telave me gishta të dorës së majtë prodhohen tone të ndryshme sipas lartësisë. Në traditën instrumentale popullore, tambura përdoret si solo – instrument dhe në kohën më të re edhe si instrumenti ansambli. Shpeshherë me këtë instrument kanë qenë të shoqëruara edhe këngët popullore. Në traditën e valles ka qenë pjesë e ansambleve që kanë qenë të përbëra prej gajdes, daulles, tamburit dhe kemas.

## Vallë, e keni ditur?



Tambura është më e përhapur në Maqedoninë Lindore, andaj edhe prej këtu e mori emrin maqedonas litarka dhe četvorka.



Dragan Dautovski



pendël e vogël  
(dridhëse)



mënyra e mbajtjes  
së pendlës së vogël -  
dridhëse



## Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi me solo – tambura në ekzekutimin e Dragan Dautovski.





## Kemaneja

*Кеманв тивко шуми,  
тивко шуми, пвсна лее.  
Бвла Рада платно бвли,  
платно бели, песна пее.*

T. Nankova



*kemaneja*

Kemaneja – instrument violinisti dhe lahute me formë dardhake në të cilën janë të shtrira tre tela. Ekziston formë e kemas me katër tela. Përbëhet prej një cope druri me tre pjesë konstruktive: **pjesa e ngurtë** (korpusi), **qafa** (zverku) dhe **koka**, dhe përpunohet prej drurit të arrës, të panjës apo ndonjë druri tjetër.

Tingulli fitohet kur me dorën e djathtë me ndihmën e harkut tërhiqet nëpër tela. Harku mund të jetë e drejtë apo e mbledhur në formë harku, me majë dhe mbajtëse në të cilën janë të shtrira qime të bishtit të kalit. Me shtypjen e telave me gishtat e dorës së majtë, prodhohet lartësi e ndryshme e toneve. Telat janë të vendosura në lartësi të ndryshme, ashtu që mund t'u bie dy telave njëkohësisht. Në telin e parë dhe të tretë plotësohet melodia, kurse në telin e dytë plotësohet toni i përmbajtjes.

Kur i bie kemas, ajo mbahet në pozitë vertikale apo në pozitë të pjerrët, e ulur në anën e djathtë. Kemaneja shfrytëzohet si shoqërues i këngëve popullore, por shumë rrallë edhe si instrument solisti.



*kemaneja me hark  
dhe me katër tela*



### Vallë, e keni ditur?

„Qamenxhe” është emër i instrumentit lahute me tre tela që ka formë të njëjtë sikurse edhe kemaneja, i cili është instrument karakteristik për Turqinë, Iranin, Sirinë, Arabinë dhe vendet tjera të kontinentit afrikan...



*Harku i qemas*



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo – ekzekutim të kemas.



## Kanoni

*Канон пее во китна гора  
и орач рано на нива ора!  
Со него песни се прават  
Канонот да Го слават!*  
T. Nankova



*kanoni*

Kanoni është instrument me tela. Ka korpus (formë) të drejtë trapezoide. Më shpesh përpunohet nga druri i panjës. Korpusi trapezoid i kanonit është i mbyllur me dërrasë të vogël të zbutur dhe me lëkurë dhie. Mbi lëkurën e dhisë është vendosur mbështetësi (ura) për tela, që është i mbështetur në katër vende. Mbi lëkurë ka dërrasë dëllinje e cila e mbulon korpusin. Në dërrasë janë të shtrira prej 24 deri në 27 tela, të grupuara nga tri në një radhë.

Tingulli prodhohet me goditjen në dërrasë me gishtëza metali. Kanoni është instrument solisti virtuoz. Në Maqedoni e sollën grupet turke udhëtuese të çallgive.



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo – ekzekutim të kanonit.



## Uti

*Утот крева врева, таму и тука.  
Нека нов ден се раѓа,  
нека живот чука,  
и зора да пука!*

T. Nankova

Uti është instrument me tela me origjinë arabe – persiane. Ka trup në formë barnjakozi – dardhake. Tek disa prej tyre, qafa është më e shkurtër, kurse tek disa është më e gjatë. Në të është koka me pykëza në të cilat shtrihen telat. Numri i telave është i ndryshëm dhe lëviz prej tetë deri në dymbëdhjetë.

Tingulli prodhohet kur me dorën e djathtë dhe me ndihmën e dridhëse, u bie telave. Me shtypjen e telave me gishtat e dorës së majtë, fitohet lartësi e ndryshme e toneve. Në praktikën instrumentale, uti më shpesh haset si instrument ansambli, në përbërje të çallgive. Uti përdoret edhe si solo instrument.



### Rekomandimi për dëgjim:

Kënga popullore „Три години станаа”, në shoqërim të orkestrës së çallgive.





## Lahuta

*Со Гудало по жица се влече  
и песната на лахутата тече.*

*Тонови остри таа вади  
за борбите на јунаци млади.*

T. Nankova



lahuta

Njëri ndër instrumentet popullore të vjetra tradicionale shqiptare është lahuta. Më shpesh përpunohet prej drurit të panjës, mirëpo mund të përpunohet edhe prej ndonjë lloji tjetër të drurit. Përbëhet nga **trup**i – i cili në anën e përparme mbulohet me lëkurë të zgjatur. Ka **qafë** të gjatë, e në fund përfundon me **kokën**, e prerë në formë të kokës së kalit, të shqiponjës apo sokolit. Instrumenti ka vetëm një tel. Toni fitohet me tërheqjen e harkut nëpër tel me dorën e djathtë. Me shtypjen e telit, me dorën e majtë, fitohen tone të ndryshme sipas lartësisë. Kur i bie lahutës, instrumenti mbahet në mënyrë vertikale, i mbështetur në gju apo në prehër.



mënyra e interpretimit



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo ekzekutim të lahutës.

## Çiftelia

*Труп, врат и глава  
имама вита става.*

*Чифтелија со свонлив глас  
мелодија за сите нас.*

T. Nankova

Çiftelia është instrument me tel, popullor, tradicional shqiptar. Në gjuhën shqipe, çifteli donë të thotë “çift”, andaj edhe instrumenti e mori emrin çifteli.

Përbëhet prej tre pjesësh: **trup**i, **qafa** e gjatë dhe **koka**. Në kokë gjenden dy pykëza të cilat shërbejnë për akordim. I ka dy tela. Njëri tel prodhon ton më të ulët dhe shërben për shoqërim, kurse teli tjetër prodhon ton më të lartë dhe në të i bie melodisë.

Tingulli fitohet kur me dorën e djathtë dhe me ndihmën e dridhëses u bie telave. Me shtypjen e telave me gishtat e dorës së majtë prodhohen tone të ndryshme sipas lartësisë.

Çiftelia



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo – ekzekutim të çiftelisë.





*Përpunimi i sharkisë*

## Sharkia

*Притисни Ги жиците со левата рака  
шаркијата ќе даде музика што се сака  
Тоновите нежни за љубов песна  
за срце што ми плени една Весна.*

T. Nankova



**Sharkia**

Sharkia është një instrument popullor, tradicional shqiptar, që numërohet në grupin e instrumenteve me tela.

Përbëhet prej tre pjesësh: **trupit, qafa dhe koka**. **Trupi** ka formë dardhake me disa hapje të vogla dhe me një hapje të madhe. **Qafa** është e gjatë rreth 50cm dhe ka 12 perde. Në **kokën** e sharkisë ka pykëza të cilat gjenden përpara, por edhe anash. Sharkia ka 5, 6 apo 7 tela. Me telin më të lartë i bie melodisë, kurse telat tjerë shërbejnë për shoqërim.

Tingulli fitohet kur me dorën e djathtë luhet nëpër tela, kurse me shtypjen e telave me gishtat e dorës së majtë prodhohet melodia.

Instrumenti i sharkisë sipas formës është i ngjashëm me çiftelinë me dy tela, e ky instrument ka zë kumbues sikurse sazi turk.



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo ekzekutim të sharkisë.

## Xhura Saz

*Џура Саз се слуша*

*шири песна за душа.*

*Со прстите од десната рака*

*свирам и пеам за тој што ме сака.*

T. Nankova



**Xhura Saz**

Xhura Saz është instrument me tela, popullor, tradicional turk, dhe i cili është instrumenti më i ri i familjes së instrumenteve Baglama. Përpunohet prej drurit të kokrrës së manës, të dëllinjës, të ahut, të arrës apo të ndonjë druri tjetër. Gjatësia e instrumentit mund të jetë prej 50 - 70cm.

Përbëhet prej tre pjesësh: **trupit, qafës dhe kokës**. **Trupi** ka formë dardhake. **Qafa** është e gjatë dhe në të shtrihen tre çifte telash. Me njërin çift tela i bie melodisë kryesore, kurse dy çiftet tjera telash shërbejnë për shoqërim. Në **kokën** e xhura sazit gjenden pykëza të cilat shërbejnë për akordim.

Mënyra tradicionale se si i bie sazit është me gishta të dorës së djathtë, kurse kënduesit profesionistë përdorin dridhëse.



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo - ekzekutim të çiftelisë.



### Detyrë:

1. Me përdorimin e IKT-së bëj një album të instrumenteve popullore me tela.





## Johanes Brams „Vallëzimi hungarez”



Johanes Brams

Johanes Brams është kompozitor, dirigjent dhe pianist gjerman i cili jetoi dhe krijoi në shekullin e 19. Rrjedh prej një familje të varfër dhe për këtë shkak nga vitet e hershme ka kënduar dhe ka fituar për ekzistencë. Ka kompozuar këngë, kompozime të korit, por edhe krijime instrumentale. Mbajti koncerte në Gjermani dhe në vendet tjera evropiane.

Për nga karakteri ka qenë i gëzuar, i disponuar përzemërsisht dhe i shoqërueshëm. Është shoqëruar edhe me dashamirët e rinj të muzikës - fëmijët.

Krijimtaria popullore gjermane dhe krijimtaria e popujve tjerë, e kryesisht këngët popullore, shumë shpesh ishin frymëzim në krijimtarinë e tij. Për këtë arsye kompozimet e tij begatohen me melodi të folklorit muzikor hungarez dhe slloven.

### „Vallëzimi hungarez nr. 5”

Vallëzimi i romëve hungarez, i quajtur **Çardash** është baza për krijimin e këtij kompozimi. Zëri i madhërishtëm i orkestrës dhe ritmi temperament, i theksuar me instrumentet me goditje, për një çast e lënë dëgjuesin në pritje dhe e krijon një disponim gëzimi.

Tërësia e dytë e vallëzimit, në ritëm qetësues, e paralajmëron reprizën e melodisë popullore e cila në mënyrë solemne dhe me përshtypje e rrumbullakëson kompozimin.

**Çardashi** është vallëzim tradicional hungarez në takt 2/4. Kjo është lojë temperamente në ritëm të shpejt, dhe shpeshherë e përfaqësuar në krijimtarinë e kompozitorëve hungarezë dhe kompozitorëve të vendeve tjera.



vallja “Çardash”



### Detyra:

1. Caktoje llojin e veprës muzikore sipas mënyrës së ekzekutimit.
2. Zgjidhe një partner dhe vallëzo në ritmin e çardashit.



## Daullja

*На сред село тапан чука,  
тапан чука, рум-дум дум.  
Опа, опа дедо клечи  
опа опа, тапан ечи.*

T. Nankova



*daullja*

Daullja është instrument me goditje tradicionale maqedonase që bëhet prej drurit të ahut, të arrës apo drurit të gështenjës.

E hasim shpeshherë me dy madhësi: daulle e madhe që emërohet si **daulle** dhe daulle e vogël që emërohet si **daullëze**. Rrethi i daulles përpunohet më së shpeshti prej drurit të ahut, të arrës dhe drurit të gështenjës. Në ty dyja anët e rrethit është e mbuluar me lëkurë deleje apo lëkurë dhie, e shtrënguar me litarë të cilat në mënyrë diagonale e lidhin njërin rreth me rrethin tjetër.

Tingulli i daulles fitohet me goditjen e lëkurës së tendosur, me goditëse të përpunuara në mënyrë speciale të cilat quhen kukuda (shkop daulleje) dhe thupra.

**Kukuda** bëhet prej drurit të arrës dhe për nga forma i ngjanë llullës.

**Thupra** është e hollë dhe është prej thane ose shelgu.

Daullja përforcohet për shpatulla e cila vendohet në shpatullën e majtë, në pozitë që të mund të goditet nga të dyja anët. Daullja më shpesh përdoret si instrument shoqërues.



*interpretues në daulle dhe tambura*



*pjesëtarë të ShKA*



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo - ekzekutim të daulles.







mënyra e këndimit

## Dajrja

*Јас сум Даф, ме викаат дajре.  
Ме удираат со рака до сабајле.  
Прапориците ми свецкаат,  
на срцата им ги пецкаат.*

T. Nankova



dajrja

Dajrja është instrument me goditje dhe shfrytëzohet për mbajtjen e ritmit.

Përbëhet nga dy pjesë: **membrana dhe rrethi i drurit**. Membrana e dajres bëhet nga lëkura e dhisë, e shtrirë mbi **rrethin e drurit**. Në rreth lehtësisht janë të vendosura pllaka metali në çifte.

Tingulli prodhohet me goditje reciproke në lëkurë, me dorën e djathtë dhe dorën e majtë. Kur ekzekutuesi godet në dajre me njëjën e dorës dhe me gishta, ato prodhojnë tinguj të shkurtër dhe kumbues.

Përdoret si instrument solisti dhe ansambli në çallgi orkestre, së bashku me instrumentet e gajdes dhe darabukut. Dajrja shfrytëzohet në muzikë në të gjitha bashkësitë kulturore në Republikën e Maqedonisë.



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi „Врбице врбо зелена”, në shoqërim të dajres.



darabuku

## Darabuku

*Кога Диме на тарабука чука  
соседите се жалат на бука.  
В час се будам и јас  
на ечи песна на Глас.*

T. Nankova



mënyra e interpretimit

Darabuku është instrument arab me goditje. Përpunohet nga argjila dhe ka formë vazoje.

Përbëhet nga dy pjesë: **pjesa e sipërme dhe pjesa e poshtme**. Pjesa e sipërme është me sipërfaqe të gjerë rrethore dhe e mbyllur me lëkurë. Pjesa e poshtme është gyp i zbrazur, i zgjeruar në fund.

Toni prodhohet me goditje në lëkurën e shtrirë, në mënyrë reciproke me dorën e djathtë dhe dorën e majtë. Sot darabuku shpeshherë shfrytëzohet si instrument ritmi dhe në përbërje të ndryshme të orkestrave popullore.



### Rekomandimi për dëgjim:

Kompozimi për solo - ekzekutim i darabukut.



### Detyrë:

1. Me përdorimin e IKT-së bëj një album të instrumenteve popullore me goditje.



## Ајде Милке да бегаме (me dëgjim)

*popullore*



Ај - де Мил-ке да бе - га - ме, в на - ше се - ло Ма-ле - ше - во.



Мил - ка - но мо-ри мо-ме у - ба - во.

В наше село Малешево  
од три страни сонце  
грее Милкано . . .

Од три страни сонце  
грее од четврта  
месечина. Милкано . . .



### Vallë, e keni ditur?

Maleshevia gjendet në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë, e rrethuar me malet e Maleshevisë. Pasuria e pyjeve të ahut, të pishës dhe dushkut e caktuan edhe emrin e tij „Malesh - mal”. Këtu natyra me altruizmin e nënës dhuroi çdo segment të vetin. Pamjen që e ofron kjo zonë është sikurse nëpër përralla: gjelbërim i pafund dhe mjedis i pacenueshëm i pastër.

Kënga „Ајде Милке да бегаме” është shfaqje e traditës muzikore folklorike dhe e këngës popullore në rrethinën e Maleshevisë.





# Си беше еднаш едно време



The first system of musical notation consists of three staves. The top staff is for a flute, the middle for a triangle, and the bottom for a drum set. The music is in 4/4 time and begins with a treble clef. The flute part has a melody of quarter and eighth notes. The triangle and drum parts provide a rhythmic accompaniment.



The second system of musical notation continues the piece. It includes first endings (marked '1.') for the flute, triangle, and drum parts. The flute part has a key signature change to one sharp (F#) in the final measure of the first ending.



The third system of musical notation includes second endings (marked '2.') for the flute, triangle, and drum parts. The flute part has a key signature change to one flat (Bb) in the final measure of the second ending.



## Nga krijimtaria e Frederik Chopen „Mazurka në B-dur”



Frederik Chopen

Frederik Chopen (Fridiric Chopin 1810-1849) është njëri ndër kompozitorët më të mëdhenj polak të pianos. Për nga nëna ka prejardhje polake, kurse për nga babai - franceze. Në atdhe e kanë konsideruar si mrekulli prej fëmijërisë, por në moshën njëzetyjeçare e lëshoi atdheun dhe më kurrë nuk u kthye në atdhe. Në Paris e krijoi karrierën si mësues, ekzekutues dhe kompozitor.

Muzika e Chopenit për piano është me një stil të dallueshëm dhe me një gjuhë muzikore universale. Këndimi i tij ishte fisnik dhe u përcjell me ndjenja dhe emocione të forta.

Chopeni nuk ka treguar përralla, nuk ka fotografuar skena, por ka lënë që dëgjuesi personalisht ta përjetojë muzikën.

### Mazurka

Mazurka është lojë popullore polake në takt me tri pjesë dhe luhet në çifte. Njihet me karakterin e gëzueshëm dhe të kërcitjes gjatë kohës së lojës.

Mazurka ka ritëm të theksuar më së shpeshti në kohën e tretë.



Një pjesë të krijimtarisë së Chopenit e përbëjnë përmbledhjet e lojërave: mazurkat, polonezët dhe valcerët. Këto janë krijime të njohura për muzikën polake nëpërmjet të cilave hidhen elementet folklorike.

Shpeshherë në kompozimet e tij në piano janë stilizuar më tepër lloje të lojërave popullore.



### Vallë, e keni ditur?

Në Varshavë në çdo të pestin vjet mbahet koncerti ndërkombëtar i pianistëve në nder të Frederik Chopenit. Për këtë kompozitor të madh është incizuar edhe filmi „Kënga në përkujtimin e jetës së Chopenit”.



Muzeu – shtëpia në Zhelezova Volla





# Мојата Вони Иреку океанот



The first system of music consists of three staves. The top staff is a flute part in treble clef, 3/4 time, with a key signature of one sharp (F#). The melody starts on a whole note G4, followed by quarter notes A4, B4, C5, and D5, ending with a half note E5. The middle staff is a triangle part with a 3/4 time signature, playing a steady eighth-note accompaniment. The bottom staff is a drum set part with a 3/4 time signature, playing a simple rhythmic pattern.



The second system of music consists of three staves. The top staff is a flute part in treble clef, 3/4 time, with a key signature of one sharp (F#). The melody starts on a half note G4, followed by quarter notes A4, B4, C5, and D5, ending with a half note E5. The middle staff is a triangle part with a 3/4 time signature, playing a steady eighth-note accompaniment. The bottom staff is a drum set part with a 3/4 time signature, playing a simple rhythmic pattern.



The third system of music consists of three staves. The top staff is a flute part in treble clef, 3/4 time, with a key signature of one sharp (F#). The melody starts on a half note G4, followed by quarter notes A4, B4, C5, and D5, ending with a half note E5. The middle staff is a triangle part with a 3/4 time signature, playing a steady eighth-note accompaniment. The bottom staff is a drum set part with a 3/4 time signature, playing a simple rhythmic pattern.





The first system of music consists of three staves. The top staff is a treble clef with a flute icon to its left. The middle staff has a triangle icon to its left. The bottom staff has a drum set icon to its left. The music is in 4/4 time and features a melody in the flute part, a steady eighth-note accompaniment in the triangle part, and a similar eighth-note accompaniment in the drum set part.



The second system of music consists of three staves. The top staff is a treble clef with a flute icon to its left. The middle staff has a triangle icon to its left. The bottom staff has a drum set icon to its left. The music is in 4/4 time and features a melody in the flute part, a steady eighth-note accompaniment in the triangle part, and a similar eighth-note accompaniment in the drum set part.



The third system of music consists of three staves. The top staff is a treble clef with a flute icon to its left. The middle staff has a triangle icon to its left. The bottom staff has a drum set icon to its left. The music is in 4/4 time and features a melody in the flute part, a steady eighth-note accompaniment in the triangle part, and a similar eighth-note accompaniment in the drum set part. The system includes first and second endings for all three parts, indicated by '1.' and '2.' above the staves.





## Këndojmë për iluministët tanë



Shën Kirili dhe Metodi

Vëllezërit Kirili dhe Metodi janë themeluesit e shkrimit sllav në shek. IX.

Kirili e krijoi alfabetin e parë glagolitic, i cili ka 38 shkronja dhe së bashku me vëllain e tij Metodi i përkthen librat e parë prej gjuhës greke në gjuhën e sllavishtes së vjetër.

Me veprimtarinë misionare e zgjeruan edhe Shkrimin Sllav nëpër të gjitha vendet sllave.

Pasardhësit e veprës së Kirilit dhe Metodit janë një grup nxënësish të cilët e vazhduan punën e tyre fisnike.

### Свѣши Кирил и Мѣшодѣиј (me dëgjim)

muzika: T. Radevski

Ми-на-а ве-ко-ви дол - ги и мно - гу уш - те ќе ми - нат  
ва - ши-те и - ми-ња све - ти ни - ко-гаш не - ма да зги - нат.  
По-свет-ли ли-ко-ви за нас не - ма под не - бе-сен свод  
аз - бу-ка ви - е му да - дов-те на це - ли-от слав - јан-ски род.

Виe солунските браќа,  
учители наши први,  
народот вда го учевте,  
напред со книга да врви.



И како сонцето светло  
вечно од дабо да сјае, така  
сред народ славјански,  
делото ваше ќе трае.



Me këngë në pushim  
 „Летаме”  
 (dëgjojmë dhe këndojmë me dëgjim)

Muzika: Boro Majdanac  
 teksti: Ognen Nedellkovski

Баш е до - бро да си де - те, ча - о  
 де - ца, ча - о де - ца, баш е до - бро да си пти - ца, ти си  
 пти - ца, јас сум пти - ца. О - ва дет - ство ле - та, ле - та си - те  
 зем - ји да се ми - нат, да ги ви - ди си - те чу - да  
 од Е - ква - дор па до Ки - на! Ле - та - ме, ле - та - ме, ле - та - ме, пес - на не сле - ди  
 лет, Ле - та - ме, ле - та - ме, ле - та - ме, пес - на но - си - ме низ свет, свет.  
 свет, Пес - на но - си - ме низ свет.

Баш е добро да си пчела  
 да ги допреш сите бои,  
 баш е добро да си облак  
 што на сино небо стои.

Ова детство лета, лета  
 сите земји да се минат,  
 да ги види сите чуда  
 од Еквадор, па до Кина.

рефрен:

Летаме, летаме, летаме  
 песна ни следи лет,  
 летаме, летаме, летаме  
 песна носиме низ свет.







# PËRMBAJTJA

Zgjerimi i vëllimit të toneve.....	5
Vendi i tonit si- h (e vogël).....	6
<i>За сите нас</i> (këngë për atdheun) .....	7
Vendi i tonit la - a (e vogël) .....	8
Gjinia e tonit .....	9
Shkalla a-mol - forma natyrore.....	10
Këndojmë dhe luajmë në C-dur dhe a-mol – forma natyrore.....	12
Volfgang Amadeus Mocart „Marshi turk” .....	13
Intervalet.....	14
Tercë intervali .....	15
Kuartë intervali.....	16
Ushtrime melodike me tercë dhe kuartë intervalin .....	17
<i>Ог новиот свт</i> .....	18
Kuintë intervali .....	20
Ushtrime dhe këngë melodike me kuintë intervalin .....	21
Sekstë intervali.....	22
Ushtrime dhe këngë melodike me sekstë intervalin .....	23
Septemë intervali.....	24
Ushtrime dhe këngë melodike me septemë intervalin .....	25
<i>Есен</i> .....	26
<i>Шеќери Менгуја</i> .....	27
Llojet e ekzekutimeve muzikore .....	28
Nga krijimtaria e Zapro Zapro.....	29
Shprehja dhe krijimtaria muzikore (modeli i asociacionit) .....	30
Johan Shtraus „ <i>На убаеиот син Дунае</i> ” .....	31
Krijojmë dhe luajmë (shprehja dhe krijimtaria muzikore përmes luajtjes së tërësive muzikore) .....	32
<i>Елко, елко</i> .....	34
<i>ЗиМа</i> .....	35
Folklori.....	36
Instrumentet muzikore popullore.....	37
Dëgjojmë valle popullore .....	38
Folklori muzikor (instrumentet muzikore popullore) .....	40
Surlja .....	41
Kavalli .....	42
Gajdja .....	43
Fyelli .....	44
Zamarja.....	45
Nga krijimtaria e Zhivoin Glisliq .....	46
<i>Виножито</i> .....	47
Shprehja artistike dhe letrare .....	48
Tambura.....	49
Kemaneja .....	50
Kanon.....	51
Uti .....	51
Lahuta .....	52
Çiftelia .....	52



Sharkia .....	53
Xhura Saz.....	53
Johanes Brams „Vallja hungareze” .....	54
Daullja.....	55
Dajrja .....	56
Darabuku .....	56
<i>Ајде Милке да бвгамв</i> .....	57
<i>Си беше еднаш едно време</i> .....	58
Nga krijimtaria e Frederik Shopenit ( <i>Mazurka në B-dur</i> ) .....	59
<i>Мојата Вони преку океанот</i> .....	60
Këndojmë për arsimtarët tanë .....	62
<i>„Летаме”</i> .....	63